



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIC OF KOSOVA



REPUBLIKA KOSOVA
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Datë:	03.04.2025
Referencë:	ZR
Për:	Imri AHMETI, Kryetari Komunës
Nga:	Imri Semetishti, Drejtor i DPUMM
Kopje:	Diamant Bytyçi, Nënkryetar i Komunës Lulzim Qerimi, Nënkryetar i Komunës Avni Jashari, Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës
Lënda:	RAPORTI MUJOR I PUNËS – mars 2025

Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në detyrat e përcaktuara sipas Planit Vjetor të Punës për vitin 2025, ju dorëzon:

RAPORTIN MUJOR
TË PUNËS PËR PERIUdhËN RAPORTUESE 01.03.2025-31.03.2025

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periudhës raportuese DPUMM- në sektorin e Urbanizmit ka zhvilluar aktivitetet themelore si vijon:

Gjatë kësaj periudhe DPUMM ka trajtuar disa prej lëndëve të pranuar dhe kerkesave të bartura. Gjatë muajit mars 2025 janë pranuar gjithsejtë 65-kërkesa të natyrave të ndryshme, kurse të bartura kanë qenë 21 lëndë, që në total rezulton të jenë 86 lëndë për shqyrtim. Prej tyre janë trajtuar gjithsejtë 57 kërkesa, 37 të miratuara, 14 të refuzuara, 1 pushim procedure dhe 5 të ceduara.

Për shqyrtim në muajin vijues barten 29 lëndë të natyrave të ndryshme, të cilat janë pranuar ditëve të fundit të muajit janar.

Statusi i trajtimit të lëndëve të pranuar dhe atyre të bartura është prezantuar në pjesën tabelare.

Në kuadër të aktiviteteve të tjera DPUMM ka kryer edhe aktivitete të tjera.

Në fushën e shqyrtimit të kërkesave është vazhduar me intensifikimin e angazhimeve për shqyrtimin e tyre brenda afateve ligjore.

Pjesë e veçantë e shqyrtimit të kërkesave është edhe procedura e lëshimit të konkluzioneve për pagesen e taksave sipas kategorive në vijim:

1. Konkluzion për taksë për leje ndërtimore – 7;
2. Konkluzion për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore 7;
3. Konkluzion për leje mjedisore komunale – 2;
4. Konkluzion për leje rrënimi – 1; dhe
5. Konkluzion për certifikatë legalizimi – 3.

Aktivitete të tjera janë kryer edhe:

1. Informatat për çështjet mjedisore – dërguar Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës – MMPHI;
2. Përgatitja e lëndëve sipas kërkesave të auditorëve të jashtëm dhe auditorëve të brendshëm; dhe

Është në zbatim e sipër programi për regjistrimin e adresave zyrtare, proces që zbatohet nga AKK. Procesi mbikëqyret dhe mbështetet nga DPUMM.

Aktivitete të veçanta janë kryer si:

Aktivitetet themelore për muajin vijues:

Vazhdimi i angazhimeve për shqyrtimin e lëndëve.

Vazhdimi i bashkëpunimit me Drejtoratet relevante në procesin implementues të projekteve komunale.

Çështja e emërtimit të rrugëve duke pasur parasysh regjistrimin zyrtar të adresave.

STATISTIKAT

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga palët

<i>Nr.</i>	<i>Llojet e kërkesave</i>	<i>Të pranuar</i>	<i>Nga periudha e kaluar</i>	<i>Të miratura</i>	<i>Të pezulluar</i>	<i>Të refuzuar</i>	<i>Të bartura në sektor të tjerë</i>	<i>Në proces (pritje)</i>
1.	Kushte ndërtimore	13	2	6	1 push. Proced.	2	1	5
2.	Leje ndërtimi	9	5	7		1		6
3.	Leje renovimi, apo vendosje e objekteve të përkohshme							
4.	Leje rrënimi	2		1				1
5.	Certifikatë përdorimi							
6.	Kërkesa për pëlqime parimore	2		1				1
7.	Akte nga MMPHI me efekte juridike	2	1			1		2
8.	Kërkesë nga MMPHI për dorëzim dokum.		1	1				
9.	Akte nga Gjykata me efekte juridike		1					1
10.	QRTK- njoftim		1					1
11.	Nr. i shtëpisë /adresa							
12.	Informacione urbane	6	2	8				
13.	Certifikatë legalizimi /Leje Legalizimi	3	3	3		2		1
14.	Legalizimi/ Në listë të pritjes							
15.	Tërheqje e lëndës dhe vendimi për pushimin e procedures	1		1				
16.	Bashkim/ndarje e parcelave	12	2	3		5	1	5
17.	Ndarje e lokaleve		1			1		
18.	Shndërrim toke nga bujqësore në ndërtimore	1		1				
19.	Ankesa	1						1
20.	Kërkesa për pezullim të procedures							
21.	Vendosje e paneleve solare në ndërtesa							
22.	MKRS- njoftime për shtyerje te afatit		1					1
23.	Kërkesë për vazhdimin e kushteve ndertimore	1						1
24.	Kërkesa të tjera	1					1	

25.	Kërkesë për LMK	6	1	2		2		3
26.	Njoftime							
27.	Emërtim rruge	1					1	
28.	Detyra për hartim të projekteve	4		3			1	
	Gjithsejtë:	65	21	37	1	14	5	29

Në muajin janar 2025 janë dhënë 7 leje ndërtimore. Prej tyre 2 për ndërtime të larta me shumë njësi banimi (NL-B) të kategorisë së II-të, 2 leje për qëllime afariste, prej tyre 1 kategori e II-të dhe 1 kategori e I-rë e ndërtimeve, si dhe 3 leje për shtëpi banimi.

Nr.	Kategoria e ndërtimit	Sipërf. Tokës -m2	Sip.ndëtesës- m2	Destinimi	Vendi
1.	II	26061	9866.14 – B 1768.86 - A	NL- B +Afariste	Lipjan
2.	II	1053	336	Afariste	Banullë
3.	II	8708	18223.91-B 2614.61 -A	NL- B +Afariste	Lipjan
4.	II	2500	1243.37	Afarizëm	Konjuh
3.	I	1135	169.89+169.89+228.21=567.99	Banim i ulët	Lipjan
	Gjithsejtë	39457	34620.88		

Banim = 28658.04 m2

Afariste = 5962.84 m2. Prej këtyre në zonën ekonomike në Konjuh është dhënë një leje ndërtimi prej 1243.37 m2 ndërtesë afariste.

Shënim:

Nga këto të dhëna rezulton se ndërtimet për qëllime të banimit janë dukshëm më të larta krahasuar me ndërtesat për afarizëm. Ky trend nuk i shërben zhvillimit ekonomik. Sipas të dhënave të ASK-së rreth 35% e njësisve banesore në Komunën e Lipjanit janë të pashfrytëzueshme.

DISKUTIME PUBLIKE:

Gjatë muajit mars 2025 nuk kemi pasur ndonjë diskutim publik.

SFIDAT:

- Mungesë e theksuar e stafit në punë për shkak të pushimeve mjekësore;
- Konkursset për plotësimin e vendeve të lira të punës ende nuk kanë dhënë rezultate.

BUXHETI:

Gjatë muajit raportues kemi vazhduar me realizimin e të hyrave nga trajtimi i kërkesave për leje ndërtimore dhe kategoritë tjera. Gjatë këtij muaji janë realizuar të hyra si në vijim:

- Të hyrat për leje ndërtimore janë realizuar në shumë prej:149,957.94€
- Të hyrat për ndërrimin e destinimit të tokës në shumë prej:55,250.35€
- Të hyrat për leje mjedisore komunale janë realizuar në shumë prej:1,117.18€
- Të hyrat për legalizimin e ndërtesave pa leje janë realizuar në shumë prej:4,854.96€
- Te hyrat për Leje rrënimi janë realizuar në shumë prej0.00€

Shuma totale e të hyrave:211,180.43€

